



NE KONTRIBUOJMË



PËR DEMOKRACI

DEMOKRACIA ATËHERË DHE SOT

ALBULENA (15), VENIS (14), FLORJETA (15), ALTIN (14), RINESA (14), ERJON (14), DRENUSHA (14)



Ne jemi gazetarë të demokracisë dhe më poshtë mund të lexoni disa informata për demokracinë atëherë dhe sot, të shkruajtura nga ne

Sot mësuam për demokracinë e cila është formë e udhëheqjes së popullit. Në demokraci udhëheqin të gjithë qytetarët e një vendi. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke, përkatësisht nga fjala „demos“ që do të thotë popull dhe fjala „kratia“ që do të thotë udhëheqje ose qeverisje. Ajo për herë të parë u paraqit në Athinë të Greqisë në vitin 507 para erës sonë. Kjo nuk ishte demokraci e plotë, sepse në atë kohë as gratë dhe as të varfërit nuk kanë pasur të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrje. Atëherë vetëm burrat, të pasurit dhe personat mbi moshën 18 vjeçare merrnin vendimet për popullin. Kjo formë e demokracisë u quajt demokraci e drejtpërdrejtë. Ndërsa, në kohën e sotme gratë dhe të gjithë personat pa marrë parasysh fenë, racën, gjendjen ekonomike, nivelin e shkollimit, prejardhjen, kombësinë, gjuhën etj, kanë të drejtat e

tyre për vendimmarrje, arsimim, punësim dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në zgjedhje demokratike. Kjo demokraci quhet demokraci përfaqësuese. Edhe ne në Kosovë udhëheqim shtetin tonë përmes parimeve të demokracisë përfaqësuese. Mirëpo, ne kemi demokraci përfaqësuese parlamentare, e cila do të thotë se përmes votës formojmë Kuvendin e Kosovës. Kuvendi i Kosovës është i udhëhequr nga 120 deputetë të cilët zgjedhen çdo katër vjet. Edhe ne, në klasën tonë kemi zgjedhur kryetarin, sekretarin dhe arkatarin e klasës. Të drejtën për të votuar e kishim të gjithë, dhe të gjithë së bashku e zgjodhëm kryesinë e klasës sonë.

Ne, të gjithë qytetarët e Kosovës kemi shumë të drejta dhe përgjegjësi. Disa nga këto të drejta janë: e drejta e shkollimit, e drejta për punësim, e drejta për krijimin e familjes dhe e drejta e lojës. Megjithatë, ne kemi edhe përgjegjësi si: të mësojmë, të respektojmë rregullat e shkollës dhe të respektojmë njëri-tjetrin etj. Ne ju falenderojmë për mirëkuptimin dhe kohën tuaj.




Demokraci do të thotë barazi



Autorët e këtij artikulli



Paqja, një ndër elementet bazë të demokracisë



Kuvendi, vendi ku miratohen ligjet




Të gjithë kemi të drejta pa dallim race



Gazetarët e Kuvendit të Kosovës



Ne nuk diskriminojmë, mos e bëni as ju



Elementet themelore të demokracisë

POPULLI UDHËHEQ

RILIND (15), RINOR (14), GETUAR (15), FLORENT (14), RINESA (15), BLEARTA (14), ERBLINA (14)



Në këtë artikull do të mësoni se pse bëhet ndarja e pushtetit në një shtet demokratik

Ne e dijmë se kur bëhet ndarja e detyrave secili person ka mundësinë ta kryej detyrën e vet në mënyrën më të mirë të mundshme. Për këtë arsye, edhe Kosova si shtet i pavarur dhe demokratik, ndarjen e pushtetit e bën në tri degë.

Pushteti ndahet në këtë mënyrë: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësor. Pushtetin Legjislativ e ushtron Kuvendi, aty ku propozohen dhe miratohen ligjet. Në Kuvend bëjnë pjesë 120 deputetë. Roli i deputetëve është t'i përfaqësojë interesat e popullit. Në Kuvendin e Kosovës 20 prej deputetëve i takojnë komuniteteve jo shumicë, sepse Kuvendi i Kosovës i zbaton parimet e demokracisë të cilat janë: toleranca, drejtësia, solidariteti, liria, respekti, shprehja e lirë e mendimit, barazia, paqja, sovraniteti, përgjeg-

jësia etj. Në Pushtetin Ekzekutiv bën pjesë Qeveria e cila i zbaton ligjet e miratuara nga Kuvendi. Në Qeveri punojnë Kryeministri, ministrat dhe zëvendësministrat. Qeveria i propozon projektligje Kuvendit, ndërsa Kuvendi e kontrollon punën e Qeverisë.

Dega tjetër e pushtetit është Pushteti Gjyqësor, i cili ka për detyrë të vendos drejtësinë në vend. Tri llojet e gjykatave në Kosovë janë: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

Nëse këto sisteme të pushtetit, e kryejnë detyrën e tyre në mënyrë të pavarur dhe me shumë përgjegjësi, atëherë shteti funksionon shumë më mirë. Por, të gjithë duhet ta kuptojmë se ne populli jemi ata që udhëheqim në vendin tonë. Po ashtu, duhet ta kemi parasysh se të gjithë qytetarët e shtetit tonë duhet t'i zbatojnë parimet e demokracisë sepse kjo është mënyra e vetme kur secili mund të jetoj i lirë dhe i lumtur në vendin e tij.



Drejtësi dhe paqe për të gjithë popullin



Gazetarët e demokracisë

QYTETARËT E KOSOVËS DEMOKRATIKE

ARMEND (14), SINERA (14), QENDRIM (14), ELVIRA (14), VALDRIN (15) SARANDA (15), TAULANT (15), AGON (15)

Më poshtë do të mund të lexoni se cilat janë të drejtat dhe përgjegjësitë tonë në demokraci

Kosova është një vend në të cilin mbizotëron demokracia. Çdo qytetar i Kosovës ka të drejtat dhe përgjegjësitë e veta dhe kanë për detyrë t'i respektojnë ato. Ne e dimë se çdo person ka të drejtat e veta dhe askush nuk mund të ndërhyjë në to. Secili prej nesh, ka të drejtën për jetë, të drejtën për argëtim, të drejtën për besim dhe fe etj. Që nga momenti kur ne lindim kemi të drejta, e një ndër to është edhe votimi, por për ta praktikuar këtë të drejtë ne duhet ta arrijmë moshën 18 vjeçare, sepse atëherë ne jemi më të pjekur dhe më të matur në vendimet që marrim. Ne kemi të drejtë të votojmë për partinë, për të cilën ne mendojmë që është e denjë të udhëheq vendin tonë.


Ndërkaq, disa nga përgjegjësitë e qytetarëve janë: ta mbajnë ambientin e pastër, të votojnë, ta respekto-

jnë ligjin etj. Kosova është një vend i vogël dhe me popullsi të vogël, por sipas mendimit tonë, jemi një vend ku diskriminimi është shumë i rrallë. Këta persona janë shtetas të vendit tonë të cilët meritojnë respekt, liri dhe shumë gjëra që secili prej nesh i ka. Të gjithë kemi të drejtë të jetojmë lirshëm dhe të mos diskriminohemi pa marrë parasysh: fenë, racën, vendin, gjininë etj.

E rëndësishme është që gjithçka që bëjmë, të jetë në të mirë të shtetit tonë. Pra, të jemi qytetarë të sjellshëm dhe të respektojmë të drejtat dhe përgjegjësitë e secilit në mënyrë që në shtetin tonë dhe në botë të mbizotëroj barazia, paqja, dashuria dhe mos diskriminimi. Ndiqeni këshillën tonë për një jetë sa më të mirë dhe sa më demokratike.



Shembull i qytetarëve



Ne të gjithë kemi të drejtën e shkollimit



Në demokraci fiton barazia



Përkushtimi na bën të kemi rezultate të mira



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Emin Duraku“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë